



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 1761 prot.

Tiranë, më 14.10.2022

**URDHËR**

Nr. 411, datë 14.10.2022

**PËR**

**MASAT PËR REDUKTIMIN E SHPENZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË  
INSTITUCION**

Në zbatim të Nenit 14, gërma (a) të Ligjit nr. 53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, të nënit 7, gërma (e) të Rregullores së Brendshme të AAC-së, miratuar me Vendimin nr. 3, datë 28.5.2021 të Këshillit Drejtues, si dhe në kuadër të politikave të qeverisë shqiptare për të menaxhuar krizën energjitike në vend, me qëllim uljen në masën 15% të konsumit institucional të energjisë elektrike në AAC, si dhe duke marrë në konsideratë faktin që, çdo punonjës është i informuar dhe i përgjegjshëm për të kontribuar në këtë iniciativë të rëndësishme,

**URDHËROJ**

1. Monitorimin dhe rregjistrimin e shpenzimit ditor të energjisë elektrike përpara zbatimit të detyrimeve që përmban ky Urdhër. Ky monitorim të kryhet për një periudhë kohore jo më pak se pesë ditë pune, dy herë në ditë, në fillim dhe përfundim të ditës së punës. Ky monitorim do të vlejë si referencë për të monitoruar performancën e institucionit përkundrejt objektivit (15%).
2. Monitorimi do të vijojë me frekuencë 2 herë në ditë, gjatë gjithë periudhës që ky Urdhër do të jetë në forcë.
3. Marrjen e masave nga ana e gjithë secilit për të fikur dhe hequr nga priza në fund të ditës së punës pajisjet kompjuterike, printerat në zyrë dhe pajisje personale elektronike dhe elektrike në përdorim.
4. Stafin që lëviz për arsye inspektimi apo angazhime të tjera pune apo personale të justifikuara, jashtë institucionit, të fikin dhe të heqin nga priza pajisjet elektronike dhe elektrike në përdorim.
5. Gjatë kohës që pajisjet ngrohëse/ftohëse janë në punë, dyert dhe dritaret duhet të jenë të mbyllura. Ajrosja e ambienteve duhet të kryhet:
  - a. Në përfundim të orarit të punës për ato ambiente që nuk kanë informacion sensitiv
  - b. Gjatë ditës së punës për ato ambiente që kanë informacion sensitiv duke siguruar që pajisjet ngrohëse/ftohëse të jenë të fikura

6. Konsumimi i ushqimit në ambientet e punës kërkon ajrosje pas përfundimit të tij, e për rrjedhojë rrit kërkesën për energji. Është përgjegjësi e çdokujt të veprojë në përputhje me interesat e institucionit.
7. Pajisjet ngrohëse/ftohëse në sallën e mbledhjes të jenë të mbyllura për sa kohë që nuk ka aktivitet pune.
8. Organizimin e punës së përditshme brenda orarit zyrtar, 8.00-16:30 nga e hëna të enjte dhe 8.00 – 14.00 ditën e premte. Qëndrimet jashtë orarit të punës ose puna në zyrë në fundjavë do të bëhet vetëm me kërkesë apo miratim të Drejtorit Ekzekutiv. Komunikimi për këtë arsye do të bëhet me email.
9. Kryerjen e pastrimit të ambientit të institucionit brenda orareve dhe ditëve të punës të përcaktuara për punonjësit përkatës.
10. Vendosjen e kondicionerëve në punë për ngrohje, në kushte atmosferike të jashtme 16 gradë celsius e më pak, duke shmangur kështu konsum të konsiderueshëm energjie nga ngrohësit personalë. Secili të sigurohet të fikë kondicionerin në përfundim të orarit zyrtar.
11. Mbajtjen në punë të ngrohësve të ujit gjatë orarit 9.00 – 14.30 nga e hëna të enjten dhe ditën e premte 9.00-12.00.
12. Reduktimin e kohës së ndriçimit të korridoreve, nga programimi fillestar prej 10 minutash në 2 minuta, duke siguruar ndriçim sipas nevojave.
13. Fikjen dhe heqjen nga priza të printerave të vendosura në korridoret e të dy kateve të institucionit.
14. Z. Redi Bucka, caktohet të sigurojë zbatimin e këtij Urdhri nëpërmjet:
  - a. Monitorimit ditor të konsumit të energjisë përkundrejt targetit të përcaktuar
  - b. Inspektimit, këshillimit dhe raportimit të devijimeve nga ky Urdhër
  - c. Rishikimin e referencave (benchmarking) në rast të uljes së temperaturave dhe rekomandimin e masave shtesë që duhet të ndërmerren.
15. Rishikimin e masave të listuara në Urdhër, në varësi të rezultateve të matura në mënyrë konsistente, për qëllime lehtësuese apo rivlerësuese të masave.
16. Angazhimin e gjithë stafit të Autoritetit të Aviacionit Civil në zbatimin me përpikmëri dhe korrektësi të Urdhrit.
17. Ky Urdhër hyn në fuqi më datën 17 Tetor 2022, ora 08:00.

## DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

